



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-27687/22
Kaçanik, 14.10.2022

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa,

Në bazë të nenit 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e IX (nëntë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2022.

Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës, në sallën e komiteteve të kuvendit, me 20 tetor 2022 (e Enje), më fillim pune në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e IX (nëntë) të Rregullt të KPF-s të datës 20.10.2022, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Raporti financiar për periudhën: Janar-Shtator 2022;
3. Propozim Vendimi caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023;
4. Plani i Veprimit për parandalimin e dhunës në familje, 2023-2025.;
5. Informatë për fillimin e Vitit të Ri shkollor 2022/2023;
6. Informatë për përfundimin e Vitit shkollor 2021/2022.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 60/01-25444/22
Kaçanik, 26.09.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VIII (tetë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 26 shtator 2022. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e kuvendit, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 7 anëtarë- të gjithë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Fitore Vishi, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani dhe Rabije Sallahi.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi, drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Suhad Dullovi-DBPZHR, Ramadush Osmani-DSHPE, Hafize Sallahu- DKRS, ndërkaq nga zyrtarët ishte Fatlume Guri – Selimi nga Zyra e Informimit.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune për me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e VIII (tetë) të rregullt të KPF-a për vitin 2022, data, 26 shtator, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024- 2025;
3. Draft Rregullore për ndryshim plotësimin e Rregullores 01Nr. 02-60/01-4863/20 datë 06.07.2020 për Taksat Komunale;
4. Propozim Vendimi për Transferin e mjeteve buxhetore;
5. Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve për subvencionim të fermerëve;
6. Propozim Vendimi për themelimin e Muzeut të qytetit të Kaçanikut.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e

APROVON

Rendin e punës në përbërje prej 6 pikëve.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Kryesuesi i Kuvendit: Vërejtje në proces nuk pati, atëherë Procesverbalin e mbledhjes së kaluar e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

APROVON

Procesverbalin e mbledhjes së VII (shtatë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) të datës 25.07.2022 / Lënda: 01Nr.060/01-20180/2022.

2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024- 2025;

Kryesuesi i Kuvendit: E njoftoj KPF për takimet që ka mbajtur ekzekutivi i komunës me qytetarë, ndërkaq shtoj se një takim është mbajtur nga Kryesuesi i KK, organizuar në konsultim me KPF, ndërkaq është shqetësuese pjesëmarrja e ulët e qytetarëve. Fjalën e ka drejtori i DBF, Bahri Selimi:

z. Bahri Selimi: Sqaroj për buxhetin e projektuar për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024-2025 dhe dëgjimet publike të mbajtura nga ekzekutivi i komunës. Të gjithë sektorët në vazhdimësi i kanë adresuar kërkesat qytetarët për prioritete dhe mbi bazë e tyre është planifikuar buxheti. Buxheti për vitin 2023 është 10,674,898 € me 16% ngritje. Shpërndarja: Paga dhe Mëditje, 5,621,607.00€, Mallra dhe Shërbime, 1,498,269.00€, Shërbime Komunale, 193,500.00€, Subvencione dhe Transfere, 390,000.00€, Shpenzime Kapitale, 2,971,313.00€ apo 28%. Në vazhdim drejtori sqaroj shpenzimet e planifikuara në secilën kategori ashtu siç janë paraqitur në planifikim buxhetor, e lexoj listën e projekteve kapitale të planifikuara për vitin 2023.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Është një e mirë që është rritur buxheti, rritja nuk besoj se është në numër, por në vlerë, sepse janë rritur çmimet, me çka nuk mund të realizohen projektet që kanë mundur me u realizuar me herët me shumat buxhetore. Janë futur shumë kode buxhetore ekzistuese dhe kode të reja, a është bërë ndonjë planifikim në bazë të këtyre kodeve, sa është kostoja e kodeve të vjetra dhe atyre të reja? Të pagat dhe mëditjet, a është ngritur numri i punëtorëve që është ngritur shuma në raport me vitin e kaluar? Të projektet e planifikuara, Projekti, Ndërtimi i urës mbi lumin Neredime, e keni futur si kod 5,000€, ndërkaq ndërtimi i urave Nerodime dhe Lepenc, e keni ndarë shumën 50,000€. A është fjalën për të njëjtin projekt se është kod i ri?

znj. Ardita Rrahmani: Ndarjet buxhetore për vitin e ardhëm nga ekzekutivi i komunës për Investime Kapitale janë paraparë 30 projektet me kod të ri, 29 projekte me kod të bartur nga vitet paraprake, kjo të bënë me kuptuar se projektet në propozim buxhet me gjasë do të mbesin vetëm në letër e do të barten përsëri vit pas viti. Duke kuptuar nevojën për ndarje të reja të kodeve, nuk mundem assesi të arsyetoj një numër kaq të madh të tyre, krahasuar me mundësitë e limituara buxhetore dhe nevojës së madhe të përfundimit të projekteve të parapara ndër vite e që nuk po gjejnë zbatim tani e sa kohë.

znj. Kadrije Lika- Troni: Të projekti: Ndërtimi i kanalit të ujitjes në Biçec, Kovaçec dhe Dubravë, a e përfshinë në këtë projekt edhe Soponica?

z. Suhad Dullovi: Ndërtimi i kanalit të ujitjes është për fshatrat: Biçec, Kovaçec dhe Dubravë.

z. Agim Mani: Diferenca e ngritjes se pagave dhe mëditjeve është diku mbi 300 mijë euro, ndërkaq nëse kalkullohet kjo shumë me shtimin e 15 apo 20 punëtorëve, i bien shumë e madhe kjo shumë.

z. Bahri Selimi: Kërkesat e qytetarëve për projekte janë të mëdha, por buxheti është ky që është, kode duhet me i dhënë projekteve për me vazhduar tutje me gjetjen e donacioneve, se pa e planifikuar projektin me një kod, ministria nuk e dinë se ne e kemi në plan me realizuar projektin. Ne e kodojmë projektin me 5,000 €, pastaj hulumtojmë donacione nga ministria apo donacione tjera. Të HVK nuk është se ne i realizojmë 100% këto të hyra, zakonisht i mbledhim diku 85%. Të pagat, ka ngjitje të pagave për shkak të përvojës, plus kemi shtim të stafit 15 diku për punëtorë të shëndetësisë dhe arsimit. Në vazhdim drejtori shpjegoj për numrin e planifikuar në shëndetësi, arsim dhe administratë. Të projekti i urës, me në detaje i dinë drejtori i DSHPE, Ramadush Osmani, ose drejtori i DUKMM Qamil Stagova. Të çështja e rrugës “Idriz Seferi” e dini edhe ju se e ka potencuar edhe në KK përpjekje që i ka bërë sivjet, por nuk ka pasur mundësi me finalizuar, se investime kapitale nuk janë kryer nga niveli qendror.

z. Agim Mani: Ne si komunë as buxhetin tonë nuk kemi munduar me realizuar deri në muajin e 6 as 2% të programi i investimeve kapitale, këto shpenzime janë të potencuar në raportin 6 mujor 2022.

Kryesuesi i Kuvendit: Duhet me ia bërë me dije Agimit së OSHP nuk e ka kompletuar as bordin deri me tani dhe një pjesë e projekteve kanë qenë deri me tani në zyrat e OSHP dhe ka plot ankesa dhe asnjë komunë nuk ka pasur mundësi me lidhur kontratë pa u shqyrtuar ankesat.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi: Po debatojmë për një buxhet të vitit vijues, duke u munduar me përzgjedhur prioritetet me të mira të mundshme. Me ri përcaktim të kodeve të projekteve, me vjen keq që nuk keni qenë të gjithë pjesë e debateve, se ndoshta kishim futur edhe ndonjë prioritet, prioritetet janë vullnet i qytetarët të komunës.

2. Të çështja e projektit të rrugës “Idriz Seferi”, ministria sivjet i ka ndarë 50,000 €, vitin e kaluar kanë qenë të parapara 176,000 €, në vitin e ardhëm 150,000 €, procedurë që do të udhëhiqej përmes qeverisë me bashkëfinancim. Unë nuk e kam marrë me udhëhequr këtë projekt, sepse nuk mundet me u tenderuar me ato mjete, se vlera e projektit kushton diku mbi 400,000 €, për këtë i kam treguar edhe zëvendësministrit se kjo nuk bëhet, nuk ka pasur përgjigje. Ministrisë ia kam lënë me i udhëhequr procedurat. Projekti është i koduar nga qeveria, i financuar nga qeveria dhe i hartuar nga qeveria. Për derisa sa e ka kodin nga qeveria, ne nuk mundem për një projekt me shkuar me 2 kode, dhe kemi mbetur në këtë situatë. E dyta, çështja e buxhetit, vjet e kemi shpenzuar buxhetin 99%, sivjet është me problem, se kanë ndryshuar çmimet, se nuk punojnë kompanitë se janë ngritur çmimet, ndërkaq realizimi i projekteve bëhet me punë dhe nuk besoj se shfrytëzohet buxheti për shkak të mos reflektimit të qeverisë. Të projektet e koduara, nuk e dimë a na i financon qeveria, por si kode duhet me i pasur kërkesat për këto projekte, si projekti për shkollën “Emin Duraku”, rruga për Gërlicë, pastaj projekti për Ndërtimin e kolektor e kështu me radhë, këto janë projekte të mëdha që komuna nuk mundet t’i realizon, presim nëse do të financohen nga qeveria, apo me ndonjë donacion tjetër. Ndoshta ka bërë me hequr ndonjë kod, por pa kod nuk mundemi me lënë asnjë projekt.

znj. Ardita Rrahmani: Në debatet të cilat i kemi pasur, është diskutuar për një shumë të ndarë për rrugën “Idriz Seferi”. Me intereson të di, ku janë ato mjete?

Kryetari i Komunës: 100,000€ janë të ndara për këto projekt nga të hyrat, ne kemi menduar se do të shkojmë me bashkëfinancim të projektit dhe këto mjete nuk humbin, mjetet janë të pashpenzuara, por nuk mundemi të bëjmë zgjidhje me këto mjete, ndoshta na duhet në fund të

fundit me realizuar një pjesë të projektit, aq sa mbijnë këto mjete. Ministria për këtë vit i ka ndarë 50,000€ dhe 150,000€ për vitin vijues.

z. Bahri Selimi: Shkallët të Guri i shpumë, ky projekt duhet me u realizuar, ndërkaq për rrugën nëse shteren të gjitha mundësitë, atëherë duhet me shikuar si me realizuar, tek e fundit në vitin vijues duhet me bërë projekt me konkret për këtë rrugë.

znj. Ardita Rrahmani: Diçka konkrete për rrugën “Idriz Seferi” nuk ka, ndërkaq ne po ballafaqohemi çdo ditë me shqetësimet e qytetarëve, faji mbetet të komuna se është e kotë me i folur me kode qytetarëve se ata nuk i dinë kodet. Me intereson të di për shkallët të guri i shpumë, janë ndarë diku 7-8 mijë euro, ku saktësisht do të ndërtohen ato shkallë.

z. Ramadush Osmani: Ky projekt ka të bëjë me drejtori tjetër, por në hartim të buxhetit të gjithë jemi pjesëmarrës. Të 2 kodet, ndërtimin e urës mbi lumin Neredime dhe mbi hekurudhë, është një urë që planifikohet me u lidhur me rrugën automobilistike - bulevardi me rrugën “Skënderbeu”. Pas ndërtimit të hekurudhës, do të jetë një atraksion se ku do të ndërtohen shkallët a afër shkollës apo diku tjetër, që e mundëson pozicion me kaluar ajo urë, ndërkaq ndërtimi i urave mbi Neredime dhe Lepenc, ka të bëjë me urë lidhëse diku të ETC mbi lumin Neredime, dhe tjetra në rrugën, “Feriz Guri” mbi lumin Lepenc. Projekti për urë në f. Nikaj ekziston, ndërkaq kjo tjetra do të bëhet me mjete për hartim të projekteve. Kodet mos harroni se mbushen edhe me mjete të bartura. Të projekti i shkallëve, ka të bëjë me atraksion turistik –për ngjitje tek kalaja të guri i shpum, për hajking, nuk ndërlihet me projektin e rrugës ‘Idriz Seferi’, se janë duke u ngjitur nëpër një rrugicë jo të mirë dhe llogariten me u ndërtuar shkallë për ngjitje.

z. Agim Mani: Unë e pata fjalën për ndërtimin e urave mbi Lepenc e Neredime, a kanë me u ndërtuar 2 ura, të kodit me nr. 40 ?

z. Ramadush Osmani: Po, kjo ka të bëjë me ndërtimin e 2 urave, njëra të ETC –ura e Hazirit, dhe tjetra të Nikaj, kodit me nr. 36.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024- 2025 e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri me ia kaluar KK. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

APROVOJ

Propozim Vendimin për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024- 2025. Ky propozim Vendim i kalohet KK në procedurë për shqyrtim dhe aprovim.

3. Draft Rregullore për ndryshim plotësimin e Rregullores 01Nr. 02-60/01-4863/20 datë 06.07.2020 për Taksat Komunale;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është këtu, mund t’i shihni kërkesat që janë bërë për ndryshim plotësim të rregullores. Fjalën e ka drejtori i DSHPE, Ramadush Osmani:

z. Ramadush Osmani: Kërkesa ka ardhur nga KRM “Pastërtia” për me u ngritur tarifat. Të rregullorja e menaxhimit të mbeturinave është kategorizimi i mbeturinave, komuna ka të drejtë me i caktuar tarifat. Kompania ka kërkuar unifikim me tarifat e Ferizajt që i ka miratuar tarifat e mbeturinave, por për shkak të nivelit të komunës tonë, ne kemi shkuar me ngritje me të ulët- që mund t’i përballojnë komuna jonë, me 30% të amvisëria dhe të kategoria e parë e bizneseve,

ndërkaq kategoritë tjera me 25%. Drafti ka qenë në debat publik me qytetarë, ku kanë marrë pjesë edhe bizneset dhe grupe të interesit. Arsye e ngritjes së tyre është se janë ngritur derivatet.

Kryesuesi i Kuvendit: E Hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Në rast se ulet çmimi i derivateve, atëherë mendoj se duhet ulen edhe tarifat për mbeturina.

znj. Kadrije Lika-Troni: Kërkoj sqarim të kategoritë e bizneseve se nuk e kam të qartë dhe sa është inkasimi i qytetarëve, apo inkasohen krejt konsumatorët, apo po iu ngritët çmimi i tarifave vetëm atyre që po paguajnë.

z. Ramadush Osmani: Raporti na vjen çdo muaj, inkasimi është mbi 90% të konsumatorëve që janë në sistem dhe të bizneseve, kostoja e zhvillimit të kësaj veprimtarie është rritur, dhe çdo muaj shkon minus të nevojave të kompanisë me të hyrat të cilat i kanë. Jemi duke synuar me operuar në secilën zonë %. Mbulueshmeria krijon të hyra, por krijon kotso për deponimin e mbeturinave. Janë 4 kategori të bizneseve, e 1- trafikant etj. i kam lënë me çmimin e amvisërisë, 2 - kategoritë e shitoreve etj. pastaj 3- kemi kategoritë me zbrazje të kontejnerëve siç është komuna- një zbrazje 12 €, ndërkaq kategoritë tjera janë mujore, janë të precizuara të rregullorja për menaxhimin e mbeturinave.

z. Agim Mani: Sa është mbulueshmeria e menaxhimit të mbeturinave ? Në lagjen time nuk ka mbulueshmëri të krejt lagjes. Këtë çështje e kam ngritur edhe në legjislaturës e kaluar, kam kërkuar me pajisë lagjia me kontejnerë, mirëpo kjo nuk është bërë për shkak se rruga është e pashtruar. Fillimisht mendoj se duhet me pasur shtrirje, pastaj ngritja e çmimeve.

z. Ramadush Osmani: Tani do të dalim me plan operativ, drejtorja së bashku me inspektorët dhe pastërtinë, aty ku nuk ka mbulueshmëri, ka me iu bërë urdhëresa në afat prej 15 ditësh, se ju po e arsyetoni rrugën, por ka njerëz që nuk donë me hyrë në sistem. Përpos Kotlinës, Llanishtës që janë me mbulueshmëri me zbrazje, tjerat vende janë të mbuluara edhe me operator privat. Tani do të operojmë me 100 të mbulueshmerisë së vendit.

znj. Kadrije Lika-Troni: Çka nëse qytetarët si e potencoj edhe z. Agim Mani donë me qenë në sistem të menaxhimit të mbeturinave, ndërkaq ne nuk iu ofrojmë shërbim ?

z. Agim Mani: Kërkesa për me qenë në sistem të lagjes time është që 2 vite e gjysmë, por kjo nuk është realizuar. Unë e kam ngritur këtë çështje sa herë, keni qenë edhe ju prezentë, por nuk është marrë seriozisht kjo çështje.

z. Ramadush Osmani: Pastërtia vepron edhe në Stagovë, do të marrë si detaj pse nuk ka operuar në lagjen tuaj që po e potenconi. Ne kemi shërbim derë me derë dhe me kontejnerë aty ku nuk mundet me hyrë makineria, e caktojmë ditën dhe vendin ku i marrin mbeturinat.

znj. Ardita Rrahmani: Në rrugën “Burim Rexha” një 10 shtëpi kanë qasje në menaxhim të mbeturinave, kamioni nuk mundet me hyrë deri atje, se rruga është e ngushtë, por i sjellin në vend të caktuar, por ka edhe shtëpi tjera në këtë rrugë që nuk kanë qasje fare as kontejnerin e madh. Mendoj se kjo mos gjithë- përfshirje nuk është në rregull.

z. Ramadush Osmani: Me herët nuk kemi pasur makineri adekuate me mbuluar krejt vendet, ndërkaq tani i kemi 4 makineri në terren, ka me u bërë me planin operativ që e kemi me inspektorët dhe pastërtinë me mbuluar krejt terrenin.

Kryesuesi i Kuvendit: Inflacioni i ka prekur edhe qytetarët, e jo vetëm kompanitë. Ngritja e tarifave nuk është e madhe, megjithatë strategjia e gjithë-përfshirjes iu ndihmon me tepër kompanisë sesa ngritja e çmimeve. Duhet bërë zgjedhje për gjithë-përfshirje të menaxhimit të mbeturinave, qoftë me ndonjë mjet me të vogël se ka interesim, atyre që nuk kanë interesim është mirë me i detyruar. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar KK. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Draft Rregulloren për ndryshim plotësimin e Rregullores 01Nr. 02-60/01-4863/20 datë 06.07.2020 për Taksat Komunale; dhe e njëjta i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Propozim Vendimi për Transferin e mjeteve buxhetore;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe u miratua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e

Aprovoj

Propozim Vendimi për Transferin e mjeteve buxhetore. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve për subvencionim të fermerëve;

Kryesuesi i Kuvendit: Këto mjete janë të parapara për këtë vit buxhetor. Fjalën e ka drejtori i DBPZHR, Suhad Dullovi.

z. Suhad Dullovi: Të Pika 1.1 kërkoj të shtohet pasuesi: Mbështetja e fermerëve me mekanizëm bujqësor” (freza për tërheqje me traktor, moto kultivator me freza, shpërndarëse të plehut mineral, dhe makina spërkatëse).

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Kërkoj shpjegim, kush me i lejuar këto subvencionet në shumë prej 34,000€. Ku janë këto mjete.

z. Suhad Dullovi: Mjetet janë të DBPZHR, kanë me dalë në KK, sepse ministria ka bërë kërkesë që çështjen e subvencioneve me proceduar përmes KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Projekti i subvencioneve në bujqësi është votuar vitin e kaluar në KK vetëm si shumë, tani ministria ka kërkuar që ajo vlerë me qenë e specifikuar se cilat projekte kanë me u subvencionuar dhe kjo shpërndarje nëpër kategori me u miratuar në KK.

z. Agim Mani: A hynë në këtë vlerë edhe participimi?

Kryesuesi i Kuvendit: Po, në këtë vlerë hynë edhe participimi. Vlëra e participimit është përcaktuar të pika 1.4. Diskutime tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim me shtimin e pasuesit që e theksoj drejtori i DBPZHE të pika 1.1. freza për tërheqje me traktor, moto kultivator me

freza, shpërndarëse të plehut mineral, dhe makina spërkatëse dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar KK. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve për subvencionim të fermerëve. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Propozim Vendimi për themelimin e Muzeut të qytetit të Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: Unë në vazhdimësi në KK e kam ngritur se ku ka mbetur çështja e iniciativës qytetare për themelimin e teatrit të qytetit. Përgjigja me ka ardhur shumë vonë, dhe atë vetëm mua në kopje fizike. Unë informatën kam pasur mundësi me marrë në zyrën e drejtoreshës, por çështja është së, përgjigja është dashur me iu dërguar të gjithë anëtarëve të KK. Ku është arsyeja që nuk është dërguar me email përgjigja, unë nuk e di.

Kryesuesi i Kuvendit: Fjalën e ka drejtoresha e DKRS, Hafize Sallahi.

znj. Hafize Sallahi: Unë paraprakisht i kam publikuar në faqe të komunës takimet të cilat i kam mbajtur me iniciativën qytetare për Muzeun, nuk e di sa i përcejell. Me vendim të kryetarit, DKRS kohë me parë ka filluar me këtë propozim vendim dhe tani ka ardhur në përfundim. Iniciativa qytetare (IQ) ka bërë një kërkesë me herët dhe një kërkesë tani. Ne e kemi shqyrtuar atë kërkesë, kemi pasur takime me ta, të bashkangjitur e kenë kërkesën e IQ dhe Kërkesën e Organizatave të dala nga lufta e UÇK-së.

znj. Kadrije Lika-Troni: Përgjigja për kërkesën për çështjen e muzeut, me ka ardhur vetëm mua në formë të shkruar. Unë po kërkoj me ditur arsyet pse nuk iu ka dërguar edhe anëtarëve tjerë sikur përgjigjet tjera të cilat i marrim, se për një pyetje të cilën po e ngrit anëtari tjetër, po njoftohemi edhe ne kur po na dërgohet të gjithëve përmes emailit. Nëse nuk lejohet përgjigjen që iu ka dhënë një anëtari, atëherë të veprohet për të gjitha kërkesat njëjtë, t'i marrim atëherë në formë individuale përgjigjet në kërkesat e ngritura. Me intereson të di, pse përgjigja me është vonuar 3-4 muaj?

Kryesuesi i Kuvendit: Mirë është përgjigja me iu dërguar edhe anëtarëve tjerë, ndërkaq obligative është me ia dërguar atij që e ka ngritur. Përgjigja iu ka ardhur vetëm juve, sepse nuk është shpërndarë në formë elektronike. Kjo bëhet zakonisht kur përgjigjet vijnë me vonësë. Kjo ka ndodhë këtë herë se zakonisht përgjigjet ua përcejellim të gjithë anëtarëve.

znj. Kadrije Lika-Troni: Ne si LVV punojmë si grup punues dhe ne momentin që me vjen ndonjë përgjigje, interesohem se a e kanë marrë edhe anëtarët tjerë. Mirë është me na i dërguar përgjigjet për të gjitha kërkesat që ngritën, sepse unë kam dëshirë me i pasur.

Kryetari i Komunës: Ligjërisht Kadrije ju e keni bërë pyetjen, juve duhet me iu kthyer përgjigja, megjithatë ne e kemi bërë praktikë me ua dërguar përgjigjen të gjithëve, ndërkaq nuk jemi të obliguar dhe ka nga radhët e anëtarëve të KK që mund të mos jenë të interesuar për përgjigjen e pyetjeve të anëtarit tjetër. Me rëndësi ju e keni marrë përgjigjen, ndërkaq po fol për të tjerët pse nuk e kanë marrë përgjigjen. Ata të Iniciativës qytetare kanë qenë në zyrën time dhe ua kam shpjeguar se kjo çështje merr kohë 7-8 muaj, mirëpo kanë qenë tendencioz. Unë nuk kam dhënë datë, por iu kam thënë se sivjet do të themelohet muzeu, dhe nuk kanë pasur nevojë me iu drejtuar juve, kur unë si kryetar komune ua kam dhënë përgjigjen.

Kryesuesi i Kuvendit: Çështja që të është vonuar përgjigja është e arsyeshme që po e ngritë këtë shqetësim, ndërkaq çështja pse nuk iu ka dërguar të gjithëve, nuk është arsye. Përgjigja me e mirë është që kjo çështje është iniciuar dhe tani e kemi në shqyrtim.

znj. Hafize Sallahi: Unë e kam pasur një takim me ata të IQ dhe ata janë pajtimit që ne pa e marrë pëlqimin e muzeut kombëtar, me i konsultuar edhe komunat tjera se është një themelim i ri, se nuk mundem me shkuar ashtu veç së është një kërkesë e iniciativës qytetare, pa ditur as bazën ligjore ku me u bazuar, dhe të dhëna tjera, me proceduar në KK se ka kërkuar IQ. Ata janë pajtuar që unë me iu hyrë procedurave ligjore që me ardhur deri të ky propozim vendim. Unë e kam publikuar takimin me ta në faqe zyrtare dhe pas 1 jave me kanë shkruar se ku ka ngelur kjo çështje. Nuk është çështje që mundet me u bërë brenda javës. Vendimi mundet me u marrë në mbledhje të KK, por procedurat tjera zgjasin.

znj. Ardita Rrahmani: E përgëzoj Iniciativën qytetare (IQ) dhe vullnetin e organeve se është një çështje e domosdoshme se komuna e Kaçanikut ka histori me të madhe se komuna tjera e nuk ka muze. Çështja e finalizimit të këtij projekti dihet se merr shumë kohë, ndërkaq çështja është së mos po votojmë e të ngelë kjo çështje vetëm në letër, si çështja e teatrit. Ka qenë i njëjti kryetar, i njëjti kryesues kur është themeluar teatri, po ku ka ngel ajo çështje. Çështja e muzeut ka kosto të madhe, jemi duke aprovuar themelimin e muzeut, me caktim të objektit në shtëpinë e kulturës. Shtëpia e kulturës është votuar me qenë teatri, ndërkaq ku do të ngel teatri tani, sepse në shtëpinë e kulturës një pjesë e hapësirës është në shërbim të OJQ për me kryer aktivitete. Hapësira për muze është shumë e vogël 20-50m². Unë jam për themelimin e muzeut, ndërkaq nuk jam për objektin e shtëpisë së kulturës dhe jam kundër miratimi të çdo vendimi vetëm sa me mbetur vetëm në letër, si çështja e teatrit. A e keni parë sa e kushtueshme është, ata kërkojnë edhe staf- staf teknik, kështu që mos të mbetet vetëm në letër çështja e muzeut. Përpos që ka kosto, është çështja e bartjes se artefakteve, edhe dëmtimi i tyre kërkon kosto shtesë për bartjen e tyre.

Kryetari i Komunës: I more shembull 2 dallime të mëdha, të teatrit. Ka qenë një premtim i ministrisë me i marrë në mbikëqyrje teatrin, por nuk e realizoj këtë, ju e dini që ka qenë një presion i ministrisë të muzeut e kemi komunën e Shtimes. I kemi thirrur ekspertë se a i plotëson kushtet objekti, përgjigja ka qenë pozitive, me disa vërejtje të vogla. Stafi do të jetë ai që është, por muzeu merr kohë deri sa të funksionalizimet.

Kryesuesi i Kuvendit: Të çështja e muzeut, me muzeun mundemi me lëvizur si komunë, e që ndryshe është me teatrin, që se paku duhet me i pasur 12 veta. Shërbimi teknik është i shtëpisë së kulturës me 1-2 punëtorë tjerë. Çështja e rregullimit të relikteve na kushton meremetimi i tyre, por nuk besoj se është e madhe dhe gradualisht mundemi me pasuruar muzeun. Vendosija në objektin e shtëpisë së kulturës është e përkohshme, OJQ janë përkohësisht aty, në momentin që na duhet objekti, hapësirat ku janë OJQ ne duhet me i shfrytëzuar për veti. Është një hap i mirë, i qëlluar, i vonuar pak.

znj. Hafize Sallahi: Është me vend shqetësimi i Arditës, edhe komunat tjera nuk kanë për momentin hapësira të mëdha, ne i kemi 120m² hapësirë, i kam pasur 2-3 takime me ekspertët të muzeut kombëtar, takime me ministrin, ndoshta financiarisht nuk do të na ndihmojnë, por në fushën e ekspertëve kemi pasur takim me ministrin dhe me ekspertë të muzeut kombëtar. Arsyeja pse është e ngutshme, se po humbin artefaktet, ne duhet gjetur lokacion dhe buxhet për një shtëpi muze, por për mos me na humbur artefaktet që 22 vite paslufte, kur dihet sesi komunë kemi shumë, e për mos me humbur këto për momentin ai objekt mentalisht i plotëson kushtet. Muzeu në vazhdimësi shkon duke u pasuruar dita ditës.

z. Agim Mani: A është hapësira e mjaftueshme 120m² për muzeun, mos është 1200m² ?

znj. Hafize Sallahi: Nuk janë të mjaftueshme 120m², por ne do të dërgojmë artefakte për momentin sa ka hapësirë. Ardita e mori si shembull 20-50m² nuk është e mjaftueshme, hapësira është 120m² e jo 20m².

znj. Ardita Rrahmani: Unë e mora si shembull hapësirën, ndërkaq edhe 120m² nuk janë të mjaftueshme.

Kryesuesi i Kuvendit: Vendi i caktuar për muze është i përkohshëm, por ne duhet me filluar qoftë edhe me 20m², duke u pasuruar me hapësirë dhe artefakte, nuk ka mundësi tani me i pasur të gjitha kushtet për me funksionuar muzeu. Vendimi për themelimin të muzeut është i mirë, u cek se keni qenë pjesë e themelimit të teatrit unë dhe kryetari, dhe çdo herë që ka propozime për themelime të institucioneve të rëndësishme, unë do të jam për.

Kryetari i Komunës: Kemi komuna të mëdha që nuk kanë teatër, si çështja e Podujevës me 100.000 banorë, u pajtove Arditi se jemi vonuar në këtë drejtim, pajtohem edhe ne, nuk kemi për momentin hapësirë të mjaftueshme për teatrin dhe e treta, për derisa ekspertët zyrtarët e muzeut kombëtar na kanë thënë se i plotëson kriteret, nuk e di pse po diskutojmë, kur dihet se ata kanë më na mbikëqyrë.

znj. Ardita Rrahmani: Unë kryetar ngrita paralele këtë çështje me teatrin, që mos me ngelur vendimi vetëm në letër. Në anën tjetër, sipas mendimit tim nuk bënë me iu nënshtuar presionit qytetarë për themelimin e teatrit, e që është bërë, e tani janë po të njëjtit qytetarë që akuzojnë me të drejtë që vendimi nuk po zbatohet në praktikë. Ju kryetar tërheqtë paralele me komunën e Podujevës, unë nuk e kisha tërhequr atë, se pavarësisht sa banorë jemi, ne kemi të drejtë me i pasur këto institucione kulturore.

Kryetari i Komunës: Çështja është të kostoja, se buxheti i komunës së Podujevës është i madh. Për teatrin kemi pasur premtime nga ministria me kryer ne anën procedurale, pjesa tjetër ka me marrë në mbikëqyrje ministria, por kjo nuk u realizua. Çështjen e muzeut e kemi analizuar koston dhe do ta bëjmë gradualisht, besoj se do t'ia dalim.

znj. Ardita Rrahmani: Kostoja për funksionalizim të muzeut dihet së është jashtëzakonisht e madhe, pavarësisht koston, shpresoj të mos mbetet vetëm në letër.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar KK. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për themelimin e Muzeut të qytetit të Kaçanikut; Ky propozim Vendim Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 12:17. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KPF. Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 29 Shtator 2022 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



Komuna e Kaçanikut

01-Nr. 430/03-2255/22
13.10.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nenit 9, bazuar në Statutin e Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës së Kaçanikut në ,
nxjerr këtë:

PROPOZIM VENDIM

- për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023

Neni 1 Normat Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi Komunal i Komunës së Kaçanikut cakton normat tatimore për vitin 2023 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

- Për njësitë bujqësore të parcelave----- (0.15%)
- Për njësitë bujqësore të objekteve----- (0.15%)
- Për njësitë pyjore të parcelave----- (0.15%)
- Për njësitë rezidenciale të parcelave----- (0.15%)
- Për njësitë rezidenciale të objekteve----- (0.15%)
- Për njësitë komerciale të parcelave----- (0.18%)
- Për njësitë komerciale të objekteve----- (0.18%)
- Për njësitë industriale të parcelave----- (0.18%)
- Për njësitë industriale të objekteve----- (0.18%)

Neni 2 Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Ekonomi, financa e zhvillim dhe Zyra e Tatimit në Pronë.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal dhe do të filloj së zbatuari nga 1 janari 2023.



Kryetari i Komunës
Besim Ilazi